



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr. 369/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet Haxhi Shala nga koalicioni NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - komisionerëve të Qendrës së Votimit me numër 1304 SHFMU “Idriz Ajeti” në Lipjan, për shkak të parregullsive në ditën e votimit – mungesa e votave për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HUDHET** e pa lejuar ankesa e Haxhi Shala, kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - komisionerëve të Qendrës së Votimit me numër 1304 SHFMU “Idriz Ajeti” në Lipjan për shkak të parregullsive në ditën e votimit – mungesa e votave.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.10.2019, nga Haxhi Shala kandidat për deputet nga radhët e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - komisionerëve të Qendrës së Votimit me numër 1304 SHFMU “Idriz Ajeti” në Lipjan, në të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit të cekur më lartë përkatësisht në vendvotimet me nr.1304E/01R, 1304E/02R dhe 1304E/03D nga rezultatet e publikuara nga KQZ-ja, më figurojnë vetëm 50 vota, ndërsa në këto vendvotime kam shumë përkrahës, miq dhe njerëz që kanë punuar në shtabin tim zgjedhor të cilët më kanë raportuar se ka shumë më tepër vota. Kështu që në këtë drejtim, dyshoj se në këto vendvotime nuk më është lexuar vota drejtë dhe është devijuar vullneti qytetar dhe unë si kandidat jam dëmtuar. Në fund kërkoj nga PZAP-i që ankesën time ta aprovojë dhe të autorizoj KQZ-në, përkatësisht QNR-në të bëjë rinumërimin e kutive të votimit në vendvotimet e lartëcekura.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se: **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme, ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtrojnë ankesën në afatin prej njëzetekatër (24) orëve.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
**A nr. 369/2019 më datën 10.10.2019**

**Kryesuesi i Panelit**  
**Adnan Konushevi**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*